



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 25.2.2025

Nr: 175

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “PARTIA LËVIZJA
DEMOKRATIKE PËR NDRYSHIM”, ME KRYETAR Z. NIKOLIN STAKA, PËR
REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË
DATËS 11 MAJ 2025**

Sot më datë 25.2.2025, në seancë publike mora në shqyrtim kërkesën nr. 1238 Prot., datë 24.02.2025, me:

- Kërkues:** Partia politike “Partia Lëvizja Demokratike për Ndryshim”, me kryetar Z. Nikolin Staka
- Objekti:** Regjistrimi i partisë politike “Partia Lëvizja Demokratike për Ndryshim” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025
- Baza ligjore:** Neni 64 i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 399 datë 5.12.2024 ka caktuar datën 11 maj 2025 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.

“Partia Lëvizja Demokratike për Ndryshim”, nëpërmjet Kryetarit, Z. Nikolin Staka, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend që do të zhvillohen më datë 11 maj 2025.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, datë 24.02.2025, nëpërmjet të cilit vërtetohet se “Partia Lëvizja Demokratike për Ndryshim”, me initiale “P.L.D.N”, me Kryetar Z. Nikolin Staka, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre;

Data: 25.2.2025 Nr: 175
Ora: 14:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia Lëvizja Demokratike për Ndryshim”, me Kryetar Z. Nikolin Staka, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”

- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Partia Lëvizja Demokratike për Ndryshim”, me shkronja nistore “P.L.D.N”, me adresë: Rruga "Marin Barleti", Lgj. "Ndoc Mazi", Pll. 1100, Shkodër;
- b) Kryetari i partisë është Z. Nikolin Staka, me adresë: Rruga "Marin Barleti", Lgj. "Ndoc Mazi", Pll. 1100, Shkodër;
- c) Financieri i partisë është Z. Fatjon Mjetaj, me adresë: Rruga "Marin Barleti", Lgj. "Ndoc Mazi", Pll. 1100, Shkodër;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është Zj. Merita Preza, me adresë: Rruga "Marin Barleti", Lgj. "Ndoc Mazi", Pll. 1100, Shkodër;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga “Partia Lëvizja Demokratike për Ndryshim”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1 të nenit 64, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga “Partia Lëvizja Demokratike për Ndryshim” është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, 64 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 22.01.2025, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 Maj 2025.

V E N D O S :

1. Regjistrimin e partisë politike “Partia Lëvizja Demokratike për Ndryshim”, me kryetar Z. Nikolin Staka, me shkronjat nistore “P.L.D.N”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Illirjan CELIBASHI